



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 12426 Prot

Shkodër, më 06.09.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL”.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL ”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; neni 15, neni 16 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“; i ndryshuar, VKM-së nr.384, datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfutur sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore“; VKM-së nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; “VKM-së nr.453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti” i ndryshuar; VKM-së nr.405, datë 01.06.2016 “Për miratimin e strategjisë të strehimit social 2016-2025”; Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr. __prot. datë _____,

VENDOSI:

- I. Të miratojë sistemet e pikëzimit për programet e strehimit social të Bashkisë Shkodër, si më poshtë :
 - Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin ‘Banesa sociale me qira/subvencionimi i qirasë në treg të lire’ sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.
 - Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin ‘Banesa me kosto të ulët/subvencionimi i interesave te kredisë’ sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

Zv/Kryetar



Drejtorja e Shërbimeve Sociale,
Strehimit dhe Shëndetit Publik

Glavo Kacerrri

Drejtorja Juridike

Zekunde Sejpe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL , BASHKIA SHKODËR”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar programet sociale të strehimit kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që nevojë për strehim.

Përkatësisht bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, përcaktohet që përzgjedhja e individëve apo familjeve përfituese realizohet përmes një Sistemi Pikëzimi i cili miratohet me vendim të këshillit bashkiak, për çdo program të strehimit social që zbatohet në njësinë e vetëqeverisjes vendore bazuar në kriteret e përcaktuar në ligj.

Me qëllim zbatimin e programeve të strehimit në Bashkinë Shkodër paraqesim për miratim projekt vendim “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet të strehimit social ” sipas anekseve më poshtë:

- Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të strehimit social të “Banesave sociale me qira”, aneks 1;

- Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit e strehimit social të “Banesave me kosto të ulët”, aneks 2;

Në sistemet e pikëzimit, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, janë pasqyruar ndryshimet në lidhje me kategoritë përfituese të këtyre programeve sociale.

Gjithashtu janë reflektuar ndryshimet që përcakton VKM nr. 268 datë 29.04.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. nr.453, datë 3.7.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti” në të cilin përcaktohet që për kategoritë që përfitojnë kredi me interes 0% (familjet qiramarrëse në prona të ish pronarëve, familje të punonjësve që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës” institucioni përgjegjës për trajtimin dhe miratimin e përfituesve është EKB dhe Komisioni i Kredisë pranë EKB-së.

Duke qënë se sistemi i pikëzimit përbën instrumentin kryesor të adresimit të nevojave për aplikuesit si dhe krijon një përzgjedhje të familjeve aplikuese propozojmë miratimin e sistemeve të pikëzimit në zbatim programeve të strehimit social, sipas anekseve bashkëngjitur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!



Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Shëndetit Publik.

Gjiri Kacerr 

Aneksi 1

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA/SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREG TË LIRË		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponon banesë në pronësi	7
ii	Banesa në rrezik shembje	6
iii	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	4
iv	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	3
v	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	2
vi	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	8
ii	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	4
iii	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6
iv	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	4
v	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	3
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	3
ii	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	3
iii	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	1
iv	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	3

v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	3
vi	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	2
vii	Punonjës i repartit RENE A	
viii	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	
ix	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	2
x	Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian	2
xi	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur,	2
xii	Vajzë Nënë.	2
xiii	Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor.	2
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Familje pa të ardhura	9
ii	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të të ardhurave mesatare;	7
iii	Familje me të ardhura të ulëta, 70%-100% të të ardhurave mesatare;	5
iv	Familje me të ardhura mesatare 100%-120% të të ardhurave mesatare;	4
	TOTALI PIKË	100

Aneks 2

<p style="text-align: center;">SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT/SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TE KREDISË</p>		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponon banesë në pronësi	7
ii	Banesa në rrezik shembje	4
iii	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	4
iv	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	4
v	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
vi	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	5
ii	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	0
iii	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6
iv	Familjet e reja, ku moshja e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	7
v	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	7
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	3
ii	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	3
iii	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	0
iv	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	3

v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
vi	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	
vii	Punonjës i repartit RENE A	2
viii	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	
ix	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	3
x	Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian	4
xi	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur,	2
xii	Vajzë Nënë.	3
xiii	Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor.	2
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Familje pa të ardhura	0
ii	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të të ardhurave mesatare	6
iii	Familje me të ardhura të ulëta, 70%-100% të të ardhurave mesatare;	9
iv	Familje me të ardhura mesatare 100%-120% të të ardhurave mesatare;	10
	TOTALI PIKË	100